

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO	
SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	013
Nr. i faqeve Stranica No. pages	2
Nr. Prot. Brevi Prot. Prot. No.	1381
Data: Datum: Date:	21.03.2016
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 21 mars 2016

Ref. Nr: 54/01B

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2001), dispozitave të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe nenin 2, paragrafi 8 dhe 9 të Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës (23 mars 2015, Tiranë), merr këtë:

V E N D I M

1. Obligohet Departamenti për Arsim të Lartë për zbatimin e procedurave për vlerësim dhe njohje të diplomave të shkollave të larta profesionale dhe të gradave universitare, të fituara në institucionet jopublike (private) të arsimit të lartë, të akredituara dhe të licencuara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 8/2010 Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës.
2. Në përputhje me pikën 1 të këtij Vendimi, kërkesat për vlerësim dhe njohje të diplomave të shkollave të larta profesionale dhe të gradave universitare dorëzohen dhe shqyrtohen në Divizionin për Njohje dhe Barasvlerë në MASHT.
3. Obligohen Këshilli Kombëtar për Njohje dhe Komisionet e Ekspertëve të Divizionit për Njohje dhe Barasvlerë për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Prof. dr. Arsim BAJRAMI ministër



Iu dërgohet:

- Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit për Arsim të Lartë, MASHT;
- Divizionit për Njohje dhe Barasvlerë, MASHT;
- Këshillit Kombëtar për Njohje, MASHT;
- Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA);
- Arkivit të MASHT.